

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 080

EDUKIMI MEDIAL

Tipi i Programit: Plotësues

Hyrje

Media historikisht ka luajtur rol të rëndësishëm në formimin e mendimit të publikut. Mediat e shkruara dhe audio-vizuele kanë siguruar për popullatën e një vendi komunikimin me botën e largët, përmes transmetimeve të tyre. Varësisht nga pavarësia dhe profesionalizmi i këtyre mediave, ato kanë kontribuar në mirinformimin e publikut apo në shtrembërimin e mendimit publik përmes propagandës. Shembuj të të dyja llojeve gjejmë shumë. Në epokën e internetit jemi dëshmitarë të transformimit shumë të madh të medias dhe të qarkullimit të informacionit. Mediat tradicionale u digjitalizuan duke krijuar kanale të reja se si të përçojnë informatat te qytetarët, ndërsa media sociale bëri që informacioni të qarkullojë e riqarkullojë në mënyrë marramendëse, në të njëjtën kohë duke hapur një platformë që secili qytetar të bëhet transmetues i informacionit, krahas rolin tradicional si konsumues i informacionit.

Qytetarët gjenden para një bollëku informacioni i cili në njërin anë mund t'i mbajë mirë të informuar ata, ndërsa në anën tjetër mund t'i ekspozojë ata para rreziqeve të dezinformimit e gjuhës së urrejtjes. Prandaj qytetarët kanë nevojë për edukim medial, që i ndihmon ata ta kuptojnë dhe ta vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin. Është sidomos e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë e shkollave të edukohen në këtë drejtim.

Qëllimet e programit:

Programi i trajnimit do t'u ndihmojë pjesëmarrësve të:

- Thellojnë njohuritë e tyre lidhur me median dhe informacionin, si dhe mënyrat se si t'i shqyrtojnë ato në mënyrë kritike;
- Reflekojnë mbi mënyrën e krijimit të botëkuptimeve dhe ndikimin që ka informacionit i shërbyer në krijimin e gjykimeve;
- Krijojnë shkathtësi të vlerësimit të informacionit në mënyrë kritike, duke analizuar faktet, burimet, kontekstin, audiencën e synuar, qëllimin dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit;
- Rrisin kreativitetin e tyre në planifikimin e mësimdhënies së tyre, qoftë përmes kurrikulës, aktiviteteve ndërkurrikulare apo edhe aktiviteteve jashtëkurrikulare.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Provojnë metoda të mësimdhënies që i pajisin nxënësit me kompetenca të qytetarisë demokratike, duke ndërlidhur standardet e marrjes dhe dhënies së informacionit me kulturën demokratike në një shoqëri;
- Veprojnë si mentorë për nxënësit e tyre që janë të angazhuar në klubet mediale dhe në aktivitetet e shërbimit në komunitet

Përmbajtja:

Temat kryesore që trajtohen përfshijnë:

- Krijimi i botëkuptimeve
- Shqyrtimi kritik i informacionit
- Ruajtja e privatësisë
- Media dhe kompetencat qytetare
- Mësimdhënia e edukimit medial

Programi i trajnimit ka shkallë të lartë të ndërveprimit dhe i mban pjesëmarrësit të angazhuar vazhdimisht. Ai bazohet në metodologjinë e të mësuarit përmes përvojës dhe shfrytëzon teknika të të nxënësve në bashkëpunim, të nxënësve përmes projekteve dhe të nxënësve problemor.

Grupi i synuar

Grupi i synuar i programit të trajnimit janë mësimdhënësit e fushave të ndryshme kurrikulare dhe niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar. Në këtë trajnim është e rekomandueshme të përfshihet edhe shërbimi profesional i shkollave (drejtorët, pedagogët, psikologët), koordinatorët e cilësisë, etj. Po ashtu, ky trajnim ofrohet edhe për nxënësit që duan të aktivizohen në klubin medial, nën mbështetjen e mësimdhënësve të tyre.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi i trajnimit “Edukimi Medial” i ka 20 orë të trajnimit të cilat ofrohen përmes trajnimit 2-ditor (16 orë trajnimi) me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe koha e angazhimit për përmbushjen e detyrave që lidhen me rezultatet e programit të trajnimit (4 orë trajnimi). Trajnimi 2-ditor ka gjithsej 8 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta.

Pas trajnimit, mësimdhënësit pjesëmarrës angazhohen në gjenerimin e ideve për përfshirjen e edukimit medial përmes njësive mësimore, si lëndë me zgjedhje dhe të nxënësve përmes shërbimit në komunitet. Trajnerët ofrojnë informata kthyesë për pjesëmarrësit.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

Në rastet kur nxënësit janë pjesëmarrës, ata marrin për detyrë të hulumtojnë origjinën, vërtetësinë dhe sigurinë e një lajmi të paracaktuar, duke shqyrtuar një mjet të shqyrtimit kritik të informacionit

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 20 orë pedagogjike (16 orë trajnimi si dhe 4 orë punë në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje aktive në trajnim dhe
- Realizimi i detyrave që lidhen me programin e trajnimit.

Materialet e trajnimit

Dokumenti kryesor për trajnimin është udhëzuesi për trajnerë “Edukimi Medial”, i përkrahur me fletat e punës dhe prezantimin në Ppt.